



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2024:249951

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06155738

C.nr.305/24

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshme, Divizioni civil, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen kontestimore të propozuesve **E. B. dhe E. B.1, të dy nga fshati..., Komuna e Dragashit, Enesa Bajrami njëherit i autorizuar edhe për E. B., kundër kundërpropozuesit A. U. gjithashtu nga fshati..., Komuna e Dragashit, me objekt kontesti caktimi i masës së përkohshme të sigurisë**, me dt. 02.12.2024, jashtë seance mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Konstatohet** se propozimi i propozuesve E. B. dhe E. B.1, të dy nga fshati..., Komuna e Dragashit të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. S. B. nga Dragashi, kundër kundërpropozuesit A. U. gjithashtu nga fshati..., Komuna e Dragashit, me objekt kontesti caktimi i masës së përkohshme të sigurisë, është i **TËRHEQUR**.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e saja procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit E. B. dhe E. B.1, të dy nga fshati..., Komuna e Dragashit, E. B. njëherit edhe i autorizuar edhe për E. B.1, me datë 12.09.2024, kanë parashtruar propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, kundër kundërpropozuesit A. U. po ashtu nga fshati..., Komuna e Dragashit.

Me datë 19.09.2024, propozuesi E. B. njëherit edhe i autorizuar edhe për propozuesin E. B.1, e ka njoftuar gjykatën se tërhiqen nga propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Në bazë të nenit 261 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje: LPK) është përcaktuar: *“ Paditësi (propozuesi) mund ta tërheqë padinë (propozimin) pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri (kundërpropozuesi) e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi (propozim).”*

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Andaj, meqë palet sipas parimit të disponibilitetit e parapar me nenin 3.2 të LPK-së, lirish të mund të disponojnë me të drejtat e tyre, si dhe duke e aprovuar terheqjen e padisë respektivishtë propozimit, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform nenit 261 paragrafi 1 i LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHME - DIVIZIONI CIVIL
2024:249951, 02.12.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kunder këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesa (neni 261.4 i LPK-së)